




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Procesverbal i konsultimit publik me Rini për Qarkoren e parë Buxhetore e vitit 2024/01 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026



INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e konsultimit publik për Qarkoren e Parë Buxhetore e vitit 2024/01 dhe KAB-in për vitet 2024-2026, u publikua me datë: 12.06.2023 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/06/Kalendar-i-konsultimeve-publike-per-Qarkoren-e-Pare-Buxhetore-2024-dhe-KAB-2024-2026.pdf>

Në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon: *Komuna e Rahovecit Komuna e Rahovecit përmes grupit punues për përgatitjen e Buxhetit të Komunës për vitin 2024, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit. Nr. 1005 i datës, 29.3.2017 dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, kryetari i Komunës së Rahovecit në bashkëpunim me Zyrën për Informim, publikojnë kalendarin për organizimin e konsultimeve publike me qytetarë për buxhetin e vitit 2024 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), për vitet 2024-2026.*

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së konsultimeve publike, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendarin e konsultimeve publike për katër (4) konsultime publike në komunën e Rahovecit në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/06/Kalendar-i-konsultimeve-publike-per-Qarkoren-e-Pare-Buxhetore-2024-dhe-KAB-2024-2026.pdf>

më datë: 12.06.2023.

Po ashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar, rreth mbajtjes së konsultimit me anë të publikimit të njoftimit, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së konsultimit në atë vendbanim.

Njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik për Qarkoren me Rininë që veprojnë në Komunën e Rahovecit u publikua më datë: në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/06/Njoftim-per-konsultim-publik-me-Rinine-1.pdf>

Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber.

KONSULTIMI PUBLIK NË RAHOVEC

Konsultimi publik me Rininë që veprojnë në komunën e Rahovecit u mbajtë më: 22.6.2023 në objektin e SHL-Kosova, me fillim në ora 14:00.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë konsultim publik ishin ekzekutivi i komunës dhe zyrtar komunal ishin:

- Femra ishin:
- Meshkuj ishin:

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin:

- Femra ishin:9
- Meshkuj ishin:

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë konsultim publik.

Konsultimin e shpalli të hapur Kryetari i Komunës, z.Smajl Latifi.

Një prezantim të shkurtër rreth Qarkores dhe KAB-it e bëri Kryetari i Komunës, z. Smajl Latifi.

Smajl Latifi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ju të pranishëm. Faleminderit që sot jeni këtu.

Jemi sot këtu në konsultim publik për, për të marrë kërkesat tuaja si Rini, prioritetet që ju keni dhe më pas t'i harmonizojmë në planifikimin që bëhet për vitin 2024.

Buxheti për vitin 2024 do të jetë 20.034.785.00 Euro, Paga dhe medijtë në vlerë prej 10.300.983.00 Euro, Mallra dhe Shërbime në vlerë prej 2.466.340.00 Euro, Shërbime Komunal në vlerë prej 370.000.00 Euro, Subvencione dhe Transfere në vlera prej 890.00.00 Euro si dhe Investimet Kapitale kapin vlerën prej 6.007.462.00 Euro. Ju lus që kërkesat edhe pasi t'i paraqisni këtu, me shkrim dhe të protokoluara si sjellni dhe në Komunë, që më pas të cëdohen nëpër drejtoritë përkatëse.

Fjalën e keni ju.

Vjollca Gurgule-SHL-Kosova: Të nderuar pjesëmarrës përshëndetje, i nderuar ekzekutiv dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Fillimisht e falenderoj Kryetarin për gjithë mbështetjen që na jep vazhdimisht.

Fjalën e keni ju:

Ardiana Berisha, nxënëse: Të nderuar të pranishëm, përshëndetje!

Kërkesat nga unë janë:

- Siguria në shkolla sepse nuk është në nivelin e duhur.
- Të pajisen shkollat më me shume kabinete.
- Të ndahet buxhet më i madh për shfaqje teatrale.

Arianita Krasniqi, nxënëse: Të nderuar të pranishëm, përshëndetje!

- Te rruga Xhelal Hajda, pra Sheshi Qendror kur është paraparë të kryhet dhe sa do të ketë hapësirë për organizimin e aktiviteteve për të rinjt.

Sabrije Popaj, nxënëse: Të nderuar të pranishëm, përshëndetje!

- Kemi nevojë për psikolog në shkolla.
- SHL-Kosova të furnizohet më me shumë libra.

Zylfije Krasniqi, nxënëse: Të nderuar të pranishëm, përshëndetje!

- Të merren masa për qent endacak

Vjollca Gurgule-SHL-Kosova:

Orientimi në karrierë-nëse ekziston ndonjë kod buxhetor me organizë që të rinjt ta kenë një pasqyrë për zgjedhjen e profesioneve-drejtimeve me prespektivë, duke filluar prej klasave të nënta.

PËRGJIGJET E EKZEKUTIVIT NË PYETJET E PËRFAQËSUESËVE TË OJQ-ve.

Smjal Latifi, Kryetar i Komunës: Të nderuar të pranishëm, përshëndetje!

- Praktikant profesionale vazhdojnë në komunën tonë si dhe në sektorin privat. Ne do ti mbështesim për vizita studimore të gjithë nxënësit.
- Ne kemi kontratë tre (3) vjeçare për trajtimin e qenve endacak e cila po zbatohet!
- Teatri amator- e kemi zotim kaheerë që ta themlojmë një teatër, ne do ta mbështesim shfaqjen teatrale përmes SHL-Kosova.
- Siguria në shkolla-Ka disa programe që i organizon Policia në shkolla.
- Lidhur me angazhimin e më shumë psikologëve në shkolla,-ne kemi angazhuar psikolog nëpër shkolla.
- Drejtoria e Arsimit po vazhdon me pajsijen e shkollave me kabinete.
- Sheshi Qendror po vazhdon të ndërtohet, ku parashihet edhe hapësira për zhvillimin e aktiviteteve për të rinjtë.

Smajl Latifi: Faleminderit juve të rinj që jeni prezent dhe keni paraqitur kërkesat tuaja.

Mirë u takofshim!

Konsultimi publik përfundoi në orën: 14:39

LISTAT E NËNSHKRIMEVE


 Republika e Kosovës
 Republika Kosovo / Republic of Kosovo
 Komuna e Rahovecit
 Opština Orašac / Municipality Orašac


Lista e nënshtetësve të të cilëve pjesëmarrës në konsultim publik për Qarkoren e Parë Buxhetore
 2024 dhe KAP-in 2024-2026

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi	Nënshtetësi
1.	Arben	Durguti	Rahovec	Arben
2.	Elvedin	VEHAPI	RAHOVEC	Elvedin
3.	Envera	Bugari	Rahovec	Envera
4.	Agim	Durguti	Rahovec	Agim
5.	Ero	Spahiu	Rahovec / Qyteza	Ero
6.	Enza	Hazretu	Rahovec / Qyteza	Enza
7.	Dajana	Hajredin	Potogëri i Pashter	Dajana
8.	Leomisa	Altoneti	Potogëri i Pashter	Leomisa
9.	Dhara	Dula	Rahovec	Dhara
10.	Elham	Bashari	Rahovec	Elham
11.	Stefan	Golubi	Rahovec	Stefan
12.	Bedi	Bugari	Rahovec	Bedi
13.	Jelinda	Genç	Rahovec	Jelinda
14.	Sara	Tara	Rahovec	Sara
15.	Shuran	Hasku	Rahovec	Shuran
16.	Ernesa	Bugari	Rahovec	Ernesa
17.	Aleju	Hasku	Rahovec	Aleju
18.	Safir	Hajredin	Potogëri i Pashter	Safir
19.	Ymer	Mustafa	Potogëri i Pashter	Ymer
20.	Yll	Zeka	Potogëri i Pashter	Yll

Më 22.6.2023

FOTOGRAFI





Rahovec: 26.6.2023

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

